



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:283373

Datë: 25.02.2020

Numri i dokumentit: 00854312

P.nr.1116/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit individual, Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Ylberza Glllogjani, në lëndën penale kundër të pandehurit **M S nga P, për vepër penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 248 par 1 të KPRK-së,** duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.2677/19 Dt.29.10.2019, pas seancën publike të shqyrtimit fillestar, të mbajtur me datë 19.02.2020 në prezencë të prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj dhe të pandehurit M S, të njëjtën ditë murr, publikisht shpalli, dhe përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

M S, i lindur më .. në P, ku edhe jeton në .., Rr,“ ..” nr..., me numër personal .., i biri i Muratit dhe nënës H, e gjinisë SH, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme – të stomatologjisë, tani punon në një fabrikë të tekstitit si dizajn dhe logo, realizon pagë mujore nga puna prej 3009treqindë) euro nga puna, i pamartuar, ka numër te tel. ..., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt... rreth orës 20 në Rr. I N Pejë, me dashje ushtron dhunë psikologjike ndaj babait – të dëmtuarit M S në atë mënyrë që ditën kritike pas një mos marrëveshje në mes tyre, i pandehuri i drejtohet të dëmtuarit me fjalë fyse dhe kanosëse si: “Pjelle dhe mi jep parat ose kam me ju mbyté” me ç’rast i dëmtuari lajmëron rastin në polici.

- **Me çka ka kryer vepër penale “Dhunë në familje”, nga neni 248 par 1 të KPRK-së**

Andaj, gjykata komfor nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 23 par. 1 dhe 3, 41, 42, par. 1 nën par. 1.1, 49 par. 1 nën par. 1.1, 50, 51 par. 1 dhe 2, 52 par. 1, 4 dhe 5, 73, 74 dhe 248 par 1 KPRK-së, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, 453 par.4 te KPPRK-se, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME KUSHT

- Ashtu që të pandehurit i përcakton dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, e të cilat dënime, i pandehuri, nuk ka për tu ekzekutuar, nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale.
- Në emër të paushallit gjyqësor dhe shpenzimeve gjyqësore detyrohet të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, dhe në emër të kompensimit të viktimave shumën prej 30 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP/II Nr.2478/17 Dt.06.11.2017., ndaj të pandehurit M S nga Peja, për vepër penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 248 par 1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 19.02.2020, në prezencë të prokurores të shtetit, dhe të pandehurit M S, në të cilën seancë prokuroja e shtetit fillimisht bëri përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës dhe atë si në vijim: Me dt.13.11.2019 rreth orës 20 në Rr. .. Pejë, me dashje ushtron dhunë psikologjike ndaj babait – të dëmtuarit M S në atë mënyrë që ditën kritike pas një mos marrëveshje në mes tyre, i pandehuri i drejtohet të dëmtuarit me fjalë fyse dhe kanosëse si: “Pjelle dhe mi jep parat ose kam me ju mbytë” me ç'rast i dëmtuari lajmëron rastin në polici. Derisa kualifikimi mbetet i njëjtë.

I pandehuri pasi që u njoftua me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij dhe pasi që prokurorja e shtetit lexoj aktakuzën e përmirësuar njëjti u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës së përmirësuar.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit i cili nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, dhe mendimit të palës së dëmtuar – babait të të pandehurit, Gjykata konstatoj se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-se janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje

penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lendes si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit M S qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 248 par 1 të KPPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 73 te KPPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte, e ka pranuar fajësinë për veprën qe e ka kryer. Këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi te te pandehurit. Rrethana rënduese për te pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 73 te KPPRK-së te pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë.

Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 par.1 dhe 2 nen par. 2.3 dhe 2.6 te KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Vendimi mbi kompensimin e Viktimave të Krimit në emër të taksës në shumën prej 30€ gjykata e morri përshtatshmërisht me nenit 39 par 1, 2, 3 nën par 3.1 të Ligjit Për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e të gjitha këto duke e obliguar të akuzuarin që ti paguaj ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Gjykata nuk e udhëzoi palën e dëmtuar në kontest civil, pasi që i njëjti në seancë deklaroi që nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1116/19 më datë 19.02.2020**

Zyrtarja ligjore

Ylberza Gllgjani

Gj y q t a r i,

Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.